



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 696 Prot.

Tiranë, më 28.05 2018

VENDIM Nr. 100, datë 14.05.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 30, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 14.05.2018, pasi shqyrtoi Konceptin e sondazheve arkeologjike në kuadër të *projektit "Godinë banimi dhe shërbimesh 6 kate me 2 kat nëntokë"*, me vendndodhje në rrugën "Mbretëresha Teuta", në zonën arkeologjike "B" Durrës-subjekti "HEARS NDËRTIM" sh.p.k., paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji, Znj. Lida Miraj.

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin sondazheve arkeologjike në kuadër të *projektit "Godinë banimi dhe shërbimesh 6 kate me 2 kat nëntokë"*, me vendndodhje në rrugën "Mbretëresha Teuta", në zonën arkeologjike "B" Durrës-subjekti "HEARS NDËRTIM" sh.p.k., paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji, Znj. Lida Miraj.
2. Subjekti "HEARS NDËRTIM" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori "HEARS NDËRTIM" sh.p.k. duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori "HEARS NDËRTIM" sh.p.k. si dhe shoqëria e licencuar në arkeologji, e cila do të kryejë sondazhet arkeologjike, në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76. Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar). Rregullores "Mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut" dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazheve, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIKELA KUMBARO FURXHI
MINISTRI


SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO
